

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6396
E mërkurë, 25 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Parlamenti Studentor kundër vendosjes së refugjatëve afganë në Qendrën e Studentëve | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DY DITË PAS VRASJES ËSHTË VARROSUR MARIGONA OSMANI NGA FERIZAJ | FAQE 4-5

I JEPET LAMTUMIRA 18 VJEÇES, ARRESTOHET VRASËSI I SAJ



Shumë qytetarë dhe zyrtarë të lartë shtetërorë kanë marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të 18 vjeçes Marigona Osmani nga Ferizaj, e cila është vrarë nga partneri i saj në

mënyrë mizore. Në të njëjtën ditë policia ka arritur ta arrestojë të dyshuarin kryesor për vrasje, Dardan Krivaqa. Para ceremonisë së varrimit është protestuar në

Ferizaj, me kërkesën drejtësi për rastin. Ndërsa institucionet më të larta shtetërore janë zotuar se do t'i ndërmarrin të gjitha masat që rastet e tilla të mos përsëriten

AKTUALE



BIDENI BËN THIRRJE PËR VAKSINIM TË DETYRUAR | F. 2

SËRISH NUMËR I LARTË I VIKTIMAVE DHE I TË INFEKTUARVE NË KOSOVË | F. 3

HARADINAJ: PAKOJA EKONOMIKE QEVERITARE ËSHTË VETËM NJË MASHTRIM | F. 3



EKONOMI

AZEMI: QEVERIA KURTI NUK PO I REALIZON PREMTIMET E PUNËTORËVE TË SEKTORIT PRIVAT | F. 8

MBI 60 PËR QIND E TË ANKETUARVE E KONSIDEROJNË OBLIGIM QYTETAR BLERJEN E PRODHIMEVE VENDORE | F. 8

SPORT

ZHDRELLA: JAM LOJTAR I LIRË, ME LLAPIN U NDAMË PËR SHKAK TË ÇËSHTJEVE FINANCIARE | F. 10



KQZ-ja refuzon certifikimin e 160 kandidatëve që garojnë për zgjedhje lokale



FAQE 7



Shoqëria civile: Kuvendi fshehurazi përzgjedh kandidatët për gjyqtarë të Kushtetueses

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni bën thirrje për vaksinim të detyruar



WASHINGTON, 24 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, kërkoi nga sektori privat dhe qeveritë lokale që t'i urdhërojnë punonjësit e tyre që të vaksinohen kundër koronavirusit. Bideni i bëri komentet pasi Administrata e Ushqimit dhe Barnave në SHBA (FDA) i dha të hënën miratimin e plotë vaksinës "Pfizer/BioNTech". "Nëse jeni udhëheqës biznesi, udhëheqës jofitimprurës, udhëheqës shtetëror ose lokal, që keni pritur miratimin e plotë të

FDA-së për të kërkuar vaksinimin, unë ju bëj thirrje që ta bëni këtë tani", ka thënë Biden. Menjëherë pas njoftimit të FDA-së të hënën, Pentagoni tha se është duke u përgatitur për përfshirjen e vaksinës në listën e injeksioneve të detyrueshme për personelin ushtarak amerikan. Edhe qyteti i Nju-Jorkut tha se do të kërkojë nga mësuesit dhe stafi i shkollave publike të vaksinohen kundër koronavirusit. "Pfizer/BioNTech" është miratuar për përdorim

emergjent qysh në dhjetor. Që atëherë, mbi 204 milionë njerëz vetëm në SHBA e kanë marrë këtë vaksinë. Pak mbi gjysma e popullsisë në SHBA është e vaksinuar plotësisht kundër koronavirusit. Dy vaksinat e tjera që jepen atje janë "Moderna" dhe "Johnson&Johnson". "Moderna", gjithashtu, ka aplikuar në FDA për miratimin e plotë të vaksinës së saj, ndërsa "Johnson&Johnson" shpreson ta bëjë këtë gjatë vitit.

ShBA-ja bën thirrje për uljen e tensioneve në Mal të Zi

PODGORICË, 24 GUSHT - Shtetet e Bashkuara kanë shprehur shqetësim për "përshkallëzimin e retorikës" në Mal të Zi në prag të ceremonisë së marrjes së detyrës të mitropolitit të Kishës Ortodokse Serbe në Mal të Zi, Joanikije. ShBA-ja u bëri thirrje të gjitha palëve që të punojnë për t'i qetësuar tensionet. "Ne inkurajojmë autoritetet malazeze dhe Mitropolinë e Kishës Ortodokse Serbe që të bashkëpunojnë ngushtë dhe, mbi të gjitha, ta garantojnë sigurinë e qytetarëve", ka thënë një zëdhënës i Departamentit të Shtetit për "Zërin e Amerikës".

Kisha Ortodokse Serbe ka njoftuar se marrja e detyrës nga ana e Joanikijes do të bëhet më 5 shtator në Cetinje. Aty pritet të marrin pjesë patriarku i Kishës Ortodokse Serbe Porfirije dhe priftërinj të tjerë të lartë. Mirëpo kjo ceremoni kundërshtohet nga komuna e Cetinjës, disa organizata malazeze dhe Partia Demokratike e Socialisteve e udhëhequr nga presidenti i Malit të Zi, Millo Gjukanović. Një protestë u mbajt më 22 gusht ku u kërkuar që ceremonia e kurorëzimit të Joanikijes në Cetinje të konsiderohet si një "akt pushtues".

Departamenti i Shtetit vlerëson se Mali i Zi është i "njohur për një kohë të gjatë si një vend i tolerant" dhe se të gjithë "qytetarët duhet ta kryejnë pjesën e tyre të obligimeve për të respektuar këtë traditë krenare". "Ne u bëjmë thirrje të gjithëve, qytetarëve, udhëheqësve politikë dhe fetarë, të punojnë për qetësimin e tensioneve. Shtetet e Bashkuara mbështesin lirinë fetare, duke përfshirë të drejtën e individëve për ta praktikuar fenë e tyre lirshëm. Në të njëjtën kohë, ajo, gjithashtu, mbështet lirinë e shprehjes, përfshirë të drejtën për tubim paqësor", ka pohuar një zëdhënës i Departamentit të



Shtetit. Kuvendi Komunal i Cetinjës do të mbajë një seancë të jashtëzakonshme më 27 gusht

për të diskutuar rreth një apeli ndaj Kishës Ortodokse Serbe që të heqë dorë nga ceremonia dhe ta mbajë atë diku tjetër.

Shqipëria ende pa pasaportë Covid për udhëtime drejt BE-së



TIRANË, 24 GUSHT - Një zëdhënës e Komisionit Evropian i tha "Deutsche Welles" se procesi i pranimit të vendeve të Ballkanit në sistemin e certifikatave digjitale Covid të BE-së është në vazhdim, e së shpejti do të ketë aty vende të tjera. Certifikata digjitale e vaksinimit kundër Covid është në funksionim brenda BE-së nga 1 korriku. Vendet

anëtare të Bashkimit Evropian e njohin këtë certifikatë dhe qytetarët e pajisur me të mund të udhëtojnë të lirë, por vendet e Ballkanit kanë qenë të përjashtuara deri më tani. Para dy ditësh BE-ja futi në sistemin e saj edhe certifikatat digjitale të lëshuara nga Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Ukraina. Anasjelltas këto vende do t'i njohin certifikatat

digjitale të vendeve të BE-së. Kosova ka pasur një specifikë, sepse ka dhënë për qytetarët e saj vetëm vaksinat e njohura nga BE-ja. Shqipëria, e cila ka përdorur si vaksinën kineze, por edhe ato të njohura nga BE si "BioNTech" apo "AstraZeneca", nuk është ende pjesë e sistemit të certifikatës digjitale Covid të BE-së, por kjo pritet të ndryshojë së shpejti.

Rreth 3 800 ushtarë armenë u vranë në luftë me Azerbajxhanin

YEREVAN, 24 GUSHT - Armenia ka thënë se gjithsej 3773 pjesëtarë të saj të ushtrisë u vranë gjatë luftës 44-ditore me Azerbajxhanin në fund të vitit 2020. Njoftimi për bilancin e luftës u bë nga kryeministri Nikol Pashinian. Kjo është hera e parë që ky vend bën publik numrin e plotë të ushtarëve të vranë. Gjatë një fjalimi në parlament,

kryeministri armen tha se ende nuk dihet për fatin e 243 ushtarëve të tjerë, ndërsa disa të burgosur nga ana e Azerbajxhanit ende nuk janë kthyer në Armeni. Ai shtoi se mijëra persona u zhvendosën si rezultat i luftimeve, duke shkaktuar dëme "të jashtëzakonshme" sociale dhe ekonomike.

Dy vendet vitin e kaluar kanë luftuar gjashtë javë për rajonin e Nagorno Karabakut. Ky rajon njihet ndërkombëtarisht si pjesë e Azerbajxhanit, por kontrollohej nga armenët etnikë qysh në fillim të viteve 1990. Rreth 6 000 njerëz janë vranë në luftimet e vitit të kaluar, që kanë përfunduar me një marrëveshje armëpushimi të ndërmjetësuar

nga Moska. Sipas marrëveshjes, një pjesë e Nagorno Karabakut dhe të shtatë rrethet përreth tij janë vendosur nën administrimin e Azerbajxhanit, pas gati 30 vjetësh nën kontrollin e forcave etnike armenë. Palët ranë dakord për vendosjen e 2 000 forcave paqeruajtëse ruse në zonën e konfliktit.



Sërish numër i lartë i viktimave dhe i të infektuarve në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të martën edhe për 13 viktima të reja nga Covid-19. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, në 24 orët e fundit u konfirmuan edhe 1 901 raste të reja me Covid, bazuar në 10 848 mostra të testuara në laboratorët publikë dhe privatë.

Në 24 orët e fundit 433 pacientë u shëruan nga Covidi, ndërsa raste aktive në Kosovë janë 21 922.

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar të martën se janë 1 016 pacientë të shtrirë në klinikat Covid dhe në spitalet e përgjithshme të vendit. Prej këtyre, 902 janë të konfirmuar me sëmundjen Covid-19.

Sa i takon trajtimit, ShSKUK-ja ka njoftuar se 797 pacientë po trajtohen me oksigjeno-terapi,

ndërsa 37 janë në gjendje të rënduar shëndetësore.

Institucionet qeveritare javën e kaluar kanë marrë masa shtesë kufizimi, mirëpo situata epidemiologjike vazhdon të jetë e rënduar.

Mjekët bëjnë thirrje për vaksinim pasi, sipas tyre, që prej nisjes së fushatës së imunizimit, asnjë person i vaksinuar në Kosovë nuk ka vdekur si pasojë e koronavirusit. Vaksinimi i qytetarëve në Kosovë nisi në fund të marsit dhe aktualisht po përdoren dy vaksina për imunizim, ajo e kompanisë "AstraZeneca" dhe "Pfizer/BioNTech".

Vaksinimi i qytetarëve të Kosovës është esencial për shpëtimin e jetës së tyre dhe institucionet shëndetësore dhe qeveritare kompetente për shëndetësinë, duhet të jetë më agresive në fushatën për vaksinimin e qytetarëve, vlerëson epidemiologu Isuf



Dedushaj.

Deri më 24 gusht Kosova ka administruar mbi 720 mijë

vaksina, kurse të vaksinuar plotësisht janë 244 235 mijë persona. Një person

konsiderohet i imunizuar plotësisht 14 ditë pas marrjes së dozës së dytë të vaksinës.

Shoqëria civile: Kuvendi fshehurazi përzgjedh kandidatët për gjyqtarë të Kushtetueses

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Shoqëria civile ka reaguar për mungesën të transparencës me rastin e propozimit të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese nga Komisioni i posaçëm i Kuvendit. Përmes një reagimi për media, disa organizata të shoqërisë civile kanë bërë me dije se komisioni i posaçëm i Kuvendit për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese, i kryesuar nga deputeti Adnan Rustemi, në mënyrë të fshehur ka zhvilluar procesin për përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese. "Megjithëse në hapat fillestarë të këtij procesi më 22 korrik 2021 (në fazën e përgatitjes së pyetjeve testuese) pjesëtarë të shoqërisë civile kishin marrë pjesë në monitorim të procesit, në fazat e mëvonshme (të testimit dhe përzgjedhjes) shoqëria civile nuk është lajmëruar fare për



mbledhjet e Komisionit, megjithëse disa organizata të shoqërisë civile kishin parashtruar kërkesa dhe shprehje interesimi të zyrtarët e Kuvendit

dhe kryesuesi i Komisionit. Njëherësh, vetë kryesuesi i Komisionit, z. Rustemi, i kishte njoftuar të pranishmit në mbledhjen fillestare që për

takimet e radhës do të informohen me kohë", është thënë në reagimin për media. Organizatat e shoqërisë civile e shohin me shqetësim faktin që ky

Komision injoron përfshirjen e shoqërisë civile në një proces kaq të rëndësishëm siç është përzgjedhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. "Komisioni as nuk ka dërguar ftesa për pjesëmarrje në mbledhje të Komisionit e as nuk është përgjigjur në shprehjet e interesimit për pjesëmarrje të dërguara në adresë të tij. Kjo nuk kishte ndodhur në procesin paraprak për shqyrtimin e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku shoqëria civile në mënyrë aktive kishte marrë pjesë. Ndryshimi i kësaj praktike është i pakuptueshëm dhe pa bazë ligjore. Për më tepër, ky veprim i Komisionit prek në thelb edhe vetë integritetin e procesit të përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, zgjedhja eventuale e të cilëve do të cilësohej jotransparente", është thënë në reagimin e organizatave të shoqërisë civile.

Haradinaj: Pakoja ekonomike qeveritare është vetëm një mashtrim

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kritikuar qeverinë Kurti për qasjen e saj ndaj ekonomisë së vendit gjatë pandemisë. Haradinaj në një konferencë për media, i shoqëruar edhe nga kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi dhe eksperti i

ekonomisë, Muhamet Spahiu, ka thënë se ekonomia e Kosovës po merr goditje të rëndë dhe po shkon në drejtim negativ, derisa ka përmendur edhe pikën për gazsjellës në marrëveshjen e Uashingtonit, duke thënë se kryeministri Kurti është duke e vonuar qëllimisht. "Jemi të shqetësuar për ekonominë dhe sektorin

privat që s'është trajtuar nga qeveria. Pakoja është komplet mashtrim. Kjo pako përmban masa dhe instrumente sociale ose para që qeveria i ka kode buxhetore dhe obligim operacional që 20 vjet, pra s'është masë e re, por buxheti ekzistues i paraparë për ato qëllime", ka deklaruar lideri i AAK-së.





DY DITË PAS VRASJES ËSHTË VARROSUR MARIGONA OSMANI NGA FERIZAJ

I jepet lamtumira 18-vjeçares, arrestohet vrasësi i saj

Shumë qytetarë dhe zyrtarë të lartë shtetërorë kanë marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të 18 vjeçes Marigona Osmani nga Ferizaj, e cila është vrarë nga partneri i saj në mënyrë mizore. Në të njëjtën ditë policia ka arritur ta arrestojë të dyshuarin kryesor për vrasje, Dardan Krivaqa. Para ceremonisë së varrimit është protestuar në Ferizaj, me kërkesën drejtësi për rastin. Ndërsa institucionet më të larta shtetërore janë zotuar se do t'i ndërmarrin të gjitha masat që rastet e tilla të mos përsëriten

EPOKA ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 GUSHT - I është dhënë lamtumira e fundit 18-vjeçares Marigona Osmani nga komuna e Ferizajt e cila dy ditë më parë është vrarë nga partneri i saj.

Në ceremoninë e varrimit, në varrezat e qytetit në Ferizaj, kanë marrë pjesë mijëra qytetarë dhe shumë zyrtarë të lartë shtetërorë. I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe kryeministri Albin Kurti, i cili është zotuar se institucionet do të angazhohen maksimalisht që rastet e tilla të mos përsëriten. Duke folur para qytetarëve të pranishëm në varrim, Kurti ka deklaruar se

vraska mizore e 18-vjeçares ka sjellë shumë pikëllim dhe shumë zemërim te të gjithë. Ai ka deklaruar se fakti që i dyshuari për vrasjen e saj ka precedent penal prej viteve të mëhershme tregon se sa shumë punë duhet në ndërtimin e sistemit të drejtësisë. "Sot të gjithë ne kemi shumë pikëllim. Sot të gjithë ne kemi shumë zemërim. Jeta e një vajze të re 18-vjeçare është këputur nga një vrasje mizore. Para një ore e gjysmë i dyshuari për vrasjen që e tronditi mbarë Kosovën është arrestuar dhe tash duhet të ketë gjykim të drejtë e dënim të merituar. Bëhet fjalë për një të dyshuar i cili ka precedent penal edhe prej viteve të mëhershme në vepra të

shumta që kanë qenë shkelje të ndryshme të ligjit. Kjo tregon se sa shumë punë kemi përpara që ta drejtojmë sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të veprojmë pa vonesa, të gjykojmë drejt dhe t'i ndëshkojmë kriminelët e keqbërësit në përgjithësi", ka thënë Kurti. Ai ka treguar se në gjashtë muajt e parë të këtij viti 1063 gra e vajza kanë lajmëruar për dhunë në familje. Kurti ka thënë se kjo tregon se është rritur besimi në institucione, duke shtuar se edhe përgjegjësia institucionale duhet të jetë më e lartë. "Unë e di që të gjithë ju e keni mërzinë, dhembjen dhe pikëllimin të pashmangshëm, mirëpo njëkohësisht të pikëlluar e duke

u mërzitur nuk do të mundemi asnjëri prej nesh ta kthejmë kohën mbrapsht e ta ngjallim Marigonën. Duhet t'i mbani kujtimet më të mira, që me siguri i keni të panumërta dhe të angazhohemi bashkë familja, shoqëria dhe institucionet e shtetit që raste si vrasja mizore e Marigona Osmanit të mos e godasë më kurrë popullin tonë e familjen tuaj", është shprehur Kurti, duke i shprehur ngushëllime familjes Osmani. Pas arrestimit të Dardan Krivaqës si i dyshuar për vrasjen e 18-vjeçares Marigona Osmani, ka reaguar familja e tij. Vëllai i Dardan Krivaqës, Kastrioti, përmes rrjeteve sociale i është drejtuar opinionit publik. Fillimisht ai i ka shprehur ngushëllime familjes së 18-vjeçares, ndërsa është shprehur i tronditur me rastin ku është i përfshirë vëllai i tij. "Pranoni ngushëllimet më të sinqerta që burojnë thellë nga shpirti im, me shpresë dhe ndihmën e Allahut ta përballojmë këtë tragjedi. Ky krim makabër që e bëri 'vëllai im' na la pa asnjë fjalë të gjithëve.

Vërtet jemi të traumatizuar dhe të prekur e, mbi të gjitha, ai me krimin e bërë njolloosi dhe lëndoi tërë familjen tonë. Gjatë tërë jetës na ka sjellë probleme, por asnjëherë nuk na ka dëgjuar dhe nuk na i ka përfillur këshillat tona. Unë si vëlla i madh jam përkujdesur për familje qysh në moshë shumë të re ngaqë herët kam mbetur pa baba, por jam munduar që 'vëllanë' ta këshilloj dhe ndihmoj, por ai asnjëherë nuk ka dëgjuar", ka shkruar Dardan Krivaqa. Policia e Kosovës të martën ka arrestuar të dyshuarin për vrasjen e 18-vjeçares në Ferizaj. Pas dy ditë kërkimeve, policia ka treguar se arrestimi i Dardan Krivaqës është bërë në një fshat të komunës së Ferizajt. Sipas njoftimit të policisë, i arrestuari dyshohet për veprën penale "Vrasje e rëndë". Një ditë më herët është arrestuar edhe i dyshuari tjetër me inicialet A. S. Këtë të fundit Gjykata Themelore në Ferizaj i ka caktuar masën e paraburgimit prej një muaji.

Gjykata tregon motivet e vrasjes

Gjykata Themelore në Ferizaj ka treguar për motivet që kanë çuar në vrasjen e 18-vjeçares. Në njoftimin për media të gjykatës thuhet se i pandehuri D. K. në mënyrë mizore për motive të ulëta xhelozie e ka vrarë partneren e tij. Sipas gjykatës, i dyshuari fillimisht ka ushtruar dhunë fizike mbi viktimën. "Pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjyqtari i procedurës paraprake i Departamentit për

Krime të Rënda, Ibrahim Idrizi, ka vërtetuar faktin se ekziston dyshimi i bazuar mirë, se i pandehuri më 22 gusht 2021, në Ferizaj, në banesën e të pandehurit D. K., me dashje, në mënyrë mizore, për motive të ulëta xhelozie, për shkak se i pandehuri D. K. dyshonte se e ndjera M. O. e kishte tradhtuar me djalin e dajës së të pandehurit D., për këtë arsye i pandehuri D., një natë përpara ka ushtruar fillimisht dhunë psikike, pastaj edhe dhunë fizike, e cila ka vazhduar edhe në ditën kritike, derisa e ndjera ka ndërruar jetë, ndërsa i pandehuri A. S. gjatë gjithë kohës

ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, e i cili edhe ka marrë pjesë në ushtrimin e dhunës fizike dhe psikike", është thënë në njoftimin e gjykatës.

Protestë në Ferizaj teksa arrestohet i dyshuari për vrasjen e 18-vjeçares

Disa orë para varrimit të 18-vjeçares në qendër të Ferizaj është mbajtur një protestë e cila është organizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Bjeshkë Guri nga kjo qendër ka deklaruar se ky rast tregon se në shoqërinë e Kosovës nuk ka

vend të sigurt për gratë dhe vajzat. "Ky rast i femicidit, përveç që është duke shpërfaqur mendësinë dhunuese patriarkale, është tregues i dështimit institucional për ta trajtuar sigurinë e grave me prioritet", ka deklaruar ajo. Guri ka vlerësuar se për ta adresuar fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave, institucionet duhet të respektojnë Konventën e Stambollit, duhet të ketë dënim maksimal për vrasësit, duhet të ketë siguri për gratë dhe vajzat në të gjitha hapësirat. Ajo, po ashtu, pati një kërkesë specifike për Policinë e Kosovës. "Kemi

edhe një kërkesë drejtuar në mënyrë specifike policisë dhe kërkohet prej saj që t'i trajtojë me dinjitet dhe në mënyrë të barabartë të gjitha gratë dhe vajzat që raportojnë rastet e tyre të kanosjes, të kërcënimit, përdhunimit apo të çfarëdo rasti tjetër në baza ditore", ka thënë Guri.

Vrasja e Marigona Osmani, 18 vjeçe, ka ndodhur më 22 gusht në Ferizaj. Dy persona të dyshuar e kanë dërguar trupin e pajetë të viktimës në emergjencën e qytetit dhe më pas janë larguar. Sipas mediave, viktima kishte qenë e martuar që dy muaj me Dardan Krivaqën.



Parlamenti Studentor kundër vendosjes së refugjatëve afganë në Qendrën e Studentëve

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Parlamentit Studentor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" po kundërshton vendosjen e refugjatëve afganë në Qendrën e Studentëve. Përfaqësuesit e Parlamentit Studentor në një konferencë për media kanë lexuar një deklaratë, në të cilën kanë theksuar se Qendra e Studentëve nuk mund të mëshirojë institucionet, derisa kanë shtuar se kjo është edhe në kundërshtim me statutin e QS-së. "Gjëja e parë që duhet për të specifikuar sot dhe duhet për ta sqaruar, Parlamenti Studentor i

mirëpret të gjithë refugjatët që strehohen në Kosovë, sepse jemi popull që e kemi të ndërthurur mikpritjen e miqve. Prej fillimit të javës së kaluar, kur filluan të qarkullonin lajme se Qendra e Studentëve do të shndërrohet në një qendër strehimi për afganë, por dihet se në Kosovë ka vende të ndryshme për një gjë të tillë. Ideja e parë që u vjen në mend institucioneve është Qendra e Studentëve, kjo qendër edhe për vetë nga emri tregon që është e studentëve dhe e themeluar për të vetmen arsye që t'u shërbejë atyre. Edhe pse studentët janë

dëmtuar edhe gjatë pandemisë kur QS-ja u shndërrua në një qendër karantinimi, ajo sfidë ka kaluar. Tanimë Qendra e Studentëve nuk mund të bëhet një vend që mëshiron institucionet për t'i kryer obligimet që ata i kanë ndërmarrë", është thënë në deklaratën e Parlamentit Studentor të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Përfaqësuesit e Parlamentit Studentor kanë theksuar se nëse ky mesazh nuk ka asnjë efekt tek institucionet e vendit, atëherë do të marrin masa për protesta.



KQZ-ja refuzon certifikimin e 160 kandidatëve që garojnë për zgjedhje lokale

Prishtinë, 24 gusht (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur konferencë për media lidhur me procesin e verifikimit të kandidatëve nga institucionet e ndryshme nëse janë në pajtueshmëri me nenin 29 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë se pas verifikimeve nga institucionet e sigurisë, rezultoi se 30 subjekte politike kanë

kandidatë që nuk i plotësojnë kriteret për certifikim. "Janë 160 kandidatë nga lista prej më shumë se 5 200 kandidatësh që kanë kërkuar certifikim nga KQZ, por që kanë së paku një dënim përfundimtar në tre vjetët e fundit", ka deklaruar Valmir Elezi. Më tutje, Elezi ka thënë se këta kandidatë që kanë dënime për vepra penale në tre vjetët e fundit janë edhe në garën për kryetarë të komunave edhe për asamble komunale. Ai ka

thënë se për momentin nuk mund të bëjnë publikimin e emrave të kandidatëve që janë refuzuar të certifikohen pasi, sipas tij, këtë nuk ua lejon ligji. Zëdhënësi i KQZ-së ka thënë se partive politike do t'u jepet mundësia për t'i zëvendësuar këta kandidatë. Elezi ka thënë se deri më 8 shtator do të vazhdojnë procedurat e ankesave kur edhe do të hidhet shorti për zgjedhjet lokale. Zgjedhjet lokale në Kosovë mbahen më 17 tetor.



Kandidati i Nismës për kryetar të Malishevës takon kandidatët për asamble të katër fshatrave

MALISHEVË, 24 GUSHT (ER) - Kandidati për kryetar të komunës së Malishevës nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Ekrem Kastrati, ka takuar të martën kandidatët për asamble komunale që përfaqësojnë

fshatrat Damanek, Panorc, Rud dhe Turjakë. Kastrati përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" këtë takim e ka quajtur pozitiv. "Bashkë me socialdemokratët tanë të mirë, kandidatët për asamble, Ismet Krasniqi,

Rukije Bytyqi dhe Hasim Rudi, diskutuam lidhur me përgatitjet për zgjedhjet lokale dhe për projektet e ardhshme që synojmë t'i jetësojmë pas 17 tetorit në këto fshatra", ka shkruar Kastrati.



Jepen 500 çanta me material shkollor për nxënësit e familjeve në nevojë në Podujevë

PODUJEVË, 24 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar të martën marrëveshje bashkëpunimi me përfaqësuesin e organizatës "Qatar Charity" përmes së cilës sigurohet mbështetje me çanta dhe material shkollor për 500 nxënës nga komuna e Podujevës. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, prioritet do t'u jepet nxënësve nga familjet në nevojë, hendikepëve dhe jetimëve. Kryetari Bulliqi ka falënderuar organizatën "Qatar Charity" e cila në vazhdimësi po ndihmon komunën e Podujevës me projekte në fusha të ndryshme. "Ky është projekti i radhës që po

e realizojmë bashkë me 'Qatar Charity'. është projekt i veçantë, sepse ofron ndihmë për familjet në nevojë në prag të fillimit të vitit të ri shkollor. Ndaj falënderoj këtë organizatë për bashkëpunimin e vazhdueshëm", ka theksuar kryetari Bulliqi.

Edhe përfaqësuesi i "Qatar Charity" u shpreh falënderues ndaj komunës së Podujevës për bashkëpunim korrekt. Sipas marrëveshjes, organizata "Qatar Charity" merr përsipër të gjitha shpenzimet e realizimit të projektit. Ndërsa komuna, bazuar në rregullativën ligjore të vendit, bën shpërndarjen e materialit shkollor.



Kujtim Gashi, shefi i shtabit zgjedhor i PDK-së në Prizren



PRIZREN, 24 GUSHT (ER) - Partia Demokratike e Kosovës, Dega në Prizren, në mbledhjen e Kryesisë së Degës, me unanimitet të plotë ka vendosur shef të shtabit për zgjedhjet lokale të tetorit nënkryetarin e degës, Kujtim Gashi. "Kujtim Gashi është figurë gjithëpërfshirëse, ka eksperiencën, ekspertizën, energjinë dhe pasionin për të udhëhequr aktivitetin tonë politik. Me Kujtimin në krye të aktivitetit politik, në krye të listës sonë të kandidatëve për asamble komunale dhe si drejtues i ekipit

më të mirë për Prizrenin, fitorja është akoma më e sigurt", është bërë me dije në njoftimin e PDK-së në Prizren.

Po në këtë njoftim theksohet se "PDK-ja, përveç kandidatit më të mirë për kryetarin e ardhshëm të komunës, Shaqir Totaj, vizionit për Prizrenin që qytetarët e meritojnë, ka edhe ekipin më të mirë të asamblistëve të udhëhequr nga Kujtim Gashi, udhëheqës me eksperiencë, dinjitet, integritet dhe shumë pasion për ta reformuar qytetin tonë".

Kryeprokurori Ujkani pret në takim studentët e Fakultetit Juridik

MITROVICË, 24 GUSHT (ER) - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Ismet Ujkani, ka pritur të martën në një takim studentët e Fakultetit Juridik të universiteteve publike "Hasan Prishtina" dhe "Isa Boletini" si dhe kolegjeve private, vizitë kjo e organizuar nga "Lëvizja FOL" në kuadër të projektit "Sektori i Drejtësisë në Kosovë - i përgjegjshëm, i besueshëm dhe transparent". Qëllimi i vizitës së studentëve ishte njohja në mënyrë të

drejtëpërdrejtë me punën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Me këtë rast, kryeprokurori Ujkani i njoftoi studentët lidhur me punën, sfidat që e kanë përcjellë këtë institucion, si dhe të arriturat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë. Studentët parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me punën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, në të cilat kryeprokurori Ujkani dha përgjigje, e në fund të takimit i shoqëroi studentët nëpër ambientet e kësaj prokurorie.




KQZ-ja e Kosovës kërkon huazimin e 50 kamerave nga KQZ-ja e Shqipërisë

PRISHTINË, 24 GUSHT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të Kosovës i është drejtuar me një kërkesë të veçantë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë për huazimin e 50 kamerave regjistruese të cilat janë përdorur në ditën e zgjedhjeve parlamentare më 25 prill.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka thënë për "KosovaPress" se kanë marrë përgjigje pozitive dhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve pritët të nënshkruhet së shpejti në Tiranë. Kamerat regjistruese janë të planifikuar të përdoren vetëm në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, pra jo edhe në qendra të votimit në ditën e votimit. "Duke u nisur nga bashkëpunimi i mirë i dy institucioneve tona që kanë mes vete, KQZ-ja e Kosovës ka kërkuar nga KQZ-ja e Shqipërisë huazimin e 50 kamerave regjistruese të cilat

janë përdorur në ditën e zgjedhjeve parlamentare më 25 prill. Qëllimi i këtij huazimi është përdorimi i tyre në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve ku bëhet grumbullimi i të gjithë materialit zgjedhor pas ditës së zgjedhjeve si dhe është vendi ku bëhet përpilimi i rezultateve përfundimtare", ka treguar Elezi. Sipas zëdhënësit të KQZ-së, përdorimi i këtyre kamerave do të ndihmonte ata për rritjen e integritetit të procesit zgjedhor, pasi në këtë qendër zhvillohen disa procese të rëndësishme pas ditës së zgjedhjeve, siç është numërimi i votave me kusht dhe votave me postë si dhe bëhet rinumërimi eventual i ndonjë vendvotimi. "Përdorimi i këtyre kamerave regjistruese do ta ndihmonte KQZ-në për rritjen e integritetit të procesit zgjedhor sidomos gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit eventual të ndonjë vendvotimi në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve gjatë procesit të



zgjedhjeve lokale. Në këtë qendër, siç dihet, pas ditës së zgjedhjeve grumbullohet i gjithë materiali zgjedhor nga e

gjithë Republika e Kosovës dhe natyrisht aty bëhet edhe numërimi i votave me kusht dhe votave me postë si dhe

rinumërimi eventual i ndonjë vendvotimi", ka thënë Elezi. Zgjedhjet lokale në Kosovë do të mbahen më 17 tetor.

Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare për herë të parë kryhet operimi në zgjerimin e aortës

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 GUSHT - Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare për herë të parë është kryer një intervenim kirurgjik te një pacient i moshës së shtyrë, i cili kishte një aneurizëm (zgjerim) të aortës së barkut dhe një tumor në veshkën e majtë. Zgjerimi i arteries kryesore të trupit të njeriut, i shoqëruar me karcinomë të veshkës, është shumë i rrallë. "Pacienti i moshës 77-vjeçare kishte dhembje barku për shkak të zgjerimit të arteries kryesore me dimensione: 59 x 58 mm dhe një masë tumorale në pielonin e veshkës së majtë me dimensione: 89.6 x 34 mm

Operimi i njëkohshëm i zgjerimit të arteries kryesore të njeriut dhe largimi i veshkës tumorale bashkë me ureter nuk ishin operuar më parë në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare. Po ashtu, operimi i njëkohshëm i dy sëmundjeve të lartpërmendura është raportuar rrallë në literaturën mjekësore", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK). Sipas këtij njoftimi, pas operacionit janë kryer ekzaminimet kontrolluese, ku është konstatuar se intervenimi kirurgjik është kryer me sukses të plotë dhe pacienti pas gjashtë ditësh qëndrim në spital, është lëshuar në shtëpi në gjendje të mirë shëndetësore.

Shkarkohet drejtori i suspenduar i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka shkarkuar nga detyra drejtorin e suspenduar të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Kjo ishte pikë e rendit të ditës në mbledhjen 202-të me radhë të KPK-së, ku është diskutuar dhe aprovuar raporti gjashtëmujor i mekanizmit përcjellës ndërinstucional për veprat penale karakteristike për periudhën janar-qershor 2021. Po në këtë takim anëtarët e Këshillit Prokurorial kanë

shqyrtuar dhe aprovuar kërkesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjilanit për shpalljen e brendshme për avancim të dy pozitave në Departamentin për Krime të Rënda. "Anëtarë i KPK-së, Agron Beqa, para anëtarëve të Këshillit ka prezantuar raportin e Komisionit përzgjedhës për pozitën e drejtorit të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, me ç'rast ka njoftuar anëtarët e Këshillit se ky komision ka vendosur në

mënyrë unanime që të anulohet procesi për zgjedhjen e drejtorit të NJSHPP-së deri në nxjerrjen e një rregulloreje të re. Anëtarët e KPK-së kanë trajtuar dhe aprovuar kërkesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për caktimin e prokurorit, Zejnullah Gashi, për udhëheqës të Departamentit të Krimeve të Rënda të kësaj Prokurorie", është bërë me dije në komunikatën për media të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Mbi 60 për qind e të anketuarve e konsiderojnë obligim qytetar blerjen e prodhimeve vendore

PRISHTINË, 24 GUSHT - Pavarësisht prej konkurrencës së lartë në treg mes produkteve vendore dhe produkteve të huaja, mbizotëron perceptimi se produktet vendore janë më të mira. Këtë e tregon edhe sondazhi i fundit i realizuar nga kompania e hulumtimeve "Pyper".

Sa i përket sigurisë së produkteve, më shumë se gjysma e të anketuarve apo 63.5 për qind i konsiderojnë produktet vendore më të sigurta për t'i konsumuar sesa produktet e huaja. E prej të gjithë të anketuarve, rreth 6 në 10 persona më shumë pëlqejnë produktet vendore sesa produktet e importuara. Për më tepër, pothuajse gjysma e të anketuarve apo 48.4 për qind kanë pohuar se konsumi i produkteve vendore është rritur në 12 muajt e fundit. E për

dallim prej këtij grupi, 44.7 për qind kanë treguar se për ta nuk ka pasur ndonjë dallim në blerjen e produkteve gjatë këtij 12-muajshi të fundit, ndërsa për 8.7 për qind blerja e produkteve vendore është zvogëluar. Po ashtu, prej të gjithë të anketuarve, rreth 6 në 10 persona e konsiderojnë si obligim qytetar blerjen e prodhimeve vendore. Mirëpo, një përqindje e madhe e të anketuarve apo 68.04 për qind e konsiderojnë se nuk ka rëndësi vendi i prodhimit dhe se konsumatorët duhet të zgjedhin cilindo produkt që dëshirojnë, pavarësisht se a është vendor apo i huaj. Sondazhi në fjalë është realizuar me mostër jo të rastësishme në të cilin kanë marrë pjesë 1 200 persona anembanë Kosovës. "Pyper" është kompani që



ofron një gamë të gjerë shërbimesh si rezultat i hulumtimeve të ndryshme që i

kryen nëpërmjet aplikacionit mobil "Pyper". Kjo infrastrukturë teknologjike u mundëson të

gjithë qytetarëve të marrin pjesë në hulumtime duke u përgjigjur në pyetësorë të llojllojshëm.

Azemi: Qeveria Kurti nuk po i realizon premtimet e punëtorëve të sektorit privata

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka thënë se si rezultat i moszbatimit të ligjeve, punëtorët e sektorit privat po lëshojnë vendet e tyre të punës dhe po kërkojnë një jetë më të mirë jashtë Kosovës. Në një konferencë për media, Azemi ka thënë punëtorët e sektorit privat janë të zhgënjyer me Qeverinë e Kosovës që, sipas tij, nuk po realizon asnjë nga premtimet e bëra lidhur me këtë kategori. "Si rezultat i moszbatimit të ligjit dhe ligjeve të tjera që kanë të bëjnë në raport me punëtorët dhe punëdhënësit, ju vetëm jeni të njoftuar që një pjesë bukur e madhe e punëtorëve të sektorit privat janë duke lënë vendet e tyre të punës dhe janë duke marrë orientimin e padëshiruar dhe po shkojnë në mërgim. Megjithatë, kemi një pjesë bukur të madhe të punëtorëve që po i lirojnë vendet e tyre të punës



meqë nuk ia vlen barra qiranë, sepse shpenzimet të cilat i bënë gjatë shkuarjes në punë dhe kthimit nuk ia vlen, kështu që

nga vetë deklarimi i pronarëve të kompanive tani kemi informacione se disa kompani veç kanë filluar të mbyllën në

mungesë të punëtorëve", ka thënë Azemi. Ai ka thënë se punëtorët e sektorit privat janë të mllefosur

dhe të zhgënjyer me qeverinë Kurti, derisa ka kërkuar që punëtorët teknikë të stimulohen me shtesë për shkak të pandemisë Covid-19. "Jemi tepër të zhgënjyer me bashkëpunimin, nuk kemi dialog të mirëfilltë dhe, në fakt, mund të themi që lëvizjet e Qeverisë së Kosovës në raport me punëtorët e sektorit privat deri më tani janë zero. Paramendojeni që për pesë muaj ditë pagën minimale nuk e lëkundni as për një cent. Kemi edhe një kërkesë, që ta ketë parasysh, tani pandemia ka marrë një hov të madh, mendoj që edhe mjekëve, edhe punëtorëve teknikë dhe të arsimit duhet t'u bëhet një stimulim shtesë dhe, krahas atyre, duhet të kenë stimulim shtesë edhe për punëtorët teknikë, për punëtorët e spitaleve dhe të shkollave", ka deklaruar Azemi.

Ai ia ka kujtuar kryeministrit Albin Kurti premtimet e tij lidhur me punëtorët e sektorit privat, për të cilat ka thënë se nuk janë as afër të realizohen.

Guvernatori Mehmeti dhe ambasadori turk bisedojnë për rritjen e bashkëpunimit ekonomik


PRISHTINË, 24 GUSHT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar. Në këtë takim guvernatori Mehmeti e ka njoftuar ambasadorin turk

për zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe angazhimin e mëtejshëm të BQK-së për të ndihmuar rimëkëmbjen e ekonomisë dhe mbajtjes së sektorit financiar stabil dhe likuid në kohën kur vendi po përballë me një valë të re të pandemisë dhe me masat

për frenimin e shpërndarjes së virusit. Guvernatori Mehmeti e ka falënderuar Turqinë për ndihmën e vazhdueshme dhënë Kosovës, përfshirë edhe sektorin financiar, përmes bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së

Turqisë dhe Autoritetin Rregullativ dhe Mbikëqyrës Bankar. Nga ana tjetër, ambasadori Sakar u shpreh i lumtur për bashkëpunimin mes të dyja vendeve, derisa ofroi mbështetje të mëtutjeshme për avancimin edhe më të madh të marrëdhënieve.





LUTJA E LUFTËS

Nga: Mark TWAIN
Përkthet: Granit ZELA

Ishte koha e lavdishme e ngadhënjimit dhe ndjenjave të zjarrta popullore. Vendi kishte rrokur armët, lufta vazhdonte, në çdo kraharor digjej zjarri i shenjtë i patriotizmit, trumbetat binin, orkestrat frymore gjëmonin, pisqollat shkreheshin si të ishin lodra, fishekzjarret fishkëllenin dhe shpërthenin në qiell; në duart e gjithkujt dhe në mizërinë e çative dhe ballkoneve të shtëpive dallgëzonte deti i flamujve shumëngjyrësh nën diell; rinia vullnetare bënte marshimin e përditshëm në shëtitorët e madhe, gazmorë dhe me uniformat e reja që u rrinin bukur, kurse etërit, nënat dhe motrat, bashkë me të dashurat krenare, brohorisnin me zërat që drithëroheshin nga lumturia duke kënduar; në mbledhjet e natës njerëzit shtynin njëri-tjetrin për të dëgjuar, duke gulçuar, nën ndikimin e oratorisë patriotike e cila trazonte shpirtin e çonte peshë zemrat, ndaj dhe herë pas here fjalimet ndërpriteshin nga stuhi duartrokitjesh, derisa lotët u shkëmben teposhtë faqeve; në kisha pastorët predikonin besnikëri ndaj flamurit dhe vendit, përmendnin Zotin e Luftës, duke u lutur për mbështetjen e Tij për kauzën tonë të mirë ndërsa gojëtarja e tyre e kulluar buçiste e trondiste këdo që dëgjonte.

Ishte me të vërtetë kohë e lumtur dhe e hirshme, dhe ato pak shpirta të nxituar që guxuan të mos e praninin luftën e të vinin në dyshim drejtësinë e saj, morën aty për aty një paralajmërim kaq të rreptë dhe të inatosur sa për hir të sigurisë së tyre vetjake u tretën sysh

dhe nuk fyen më asisoj.

Mëngjesi i të dielës mbërriti, të nesërmen batalionet do të niseshin për në front. Kisha ishte plot e përplot me njerëz; ishin vullnetarët aty, fytyrat e tyre rinore ndriçonin nga ëndrrat me luftë – vegime të përparimit të palëkundur të trupave, mbledhja e forcave, vrulli i sulmit, shpatat që vetëtinin, arratia e armikut, rropama e përlëshjes, tymnaja që ngrihej në qiell, ndjekja këmba-këmbës e të mundurve, dorëzimi i tyre, kthimi nga lufta në shtëpi, si heronj prej bronzi, të mirëpritur, të adhuruar, të zhytur në detin e artë të lavdisë!

Afër vullnetarëve ishin ulur të dashurit e tyre, krenarë, të lumtur ata shiheshin me zili nga fqinjët dhe miqtë të cilët s'kishin djem dhe vëllezër për t'i dërguar atje, në fushën e nderit, për të fituar për flamurin ose, nëse nuk ia dilnin dot, të kishin fatin të përjetonin më madhështoren ndër të gjitha vdekjet madhështore. Mesha vazhdoi; u lexua një kapitull për luftën e Testamentit të Vjetër; u bë lutja e parë; ajo u pasua nga një shpërthim i muzikës se një organoje që shkundi ndërtesën dhe, sakaq, të gjithë u ngritën në këmbë, me vështrim krenar dhe zemrat që rrahin fort, ndërsa nga kraharorët gjëmoi thirrja e jashtëzakonshme:

“Zot, më i tmerrshmi Zot! Ti na urdhëron!

Pastaj ishte radha e lutjes “së gjatë”. Askush s'mbante mend diçka të ngjashme me atë lutje emocionale, prekëse dhe gjuhën e bukur që u përdor. Detyra e kësaj përgjërëte ishte, që një atë gjithnjë i mëshirshëm dhe bujar me të gjithë ne, t'i ruante ushtarët tanë të rinj e fisnikë, t'i ndihmonte, t'ua lehtësonte mundimin, t'i nixte për

vepra atdhetare, t'i bekonte, t'i mbronte në ditën e betejës dhe orën e rrezikut, t'i mbante në pëllëmbën e tij të fuqishme, t'i bënte të fortë dhe me vetë-besim, të pathyeshëm në fillimin e përgjakshëm; t'u ndihnte ta shtypnin armikun, t'i jepte flamurit dhe vendit të tyre nderin dhe lavdinë e përrjetshme.

Një i huaj në moshë të thyer hyri dhe eci me hapa të ngadaltë dhe pa zhumë nëpër rreshtin kryesor, me sytë e ngulitur tek pastori. Mbi trup mbante një raso të gjatë deri te këmbët, flokët e thinjura që zgjateshin si shkurnajë e gufmuar mbi shpatulla, fytyra e krupshme dhe me zbehtësi të çuditshme, gati-gati si e një fantazme. Megjithëse sytë e të gjithëve e ndiqnin ndërsa pyesnin veten se kush ishte, ai u çapiti i heshtur; pa u ndalur, u ngjiti në anën e predikuesit dhe qëndroi atje duke pritur. Me sytë e mbyllur predikuesi, i pavetëdijsëm për praninë e tij, vazhdoi me lutjen e tij prekëse dhe, më në fund, e përfundoi me fjalët, e shqiptuara gjithë zjarr: “Bekoji armët tona! Jepna fitoren, o Zot. Perëndia ynë, Ati dhe Mbrojtësi i tokës dhe flamurit tonë!”

I huaji e preku në krah, i bëri me shenjë të hiqej mënjane. Ashtu bëri pastori i trembur dhe i huaji zuri vendin e tij. Për pak çaste këqyri me vështrim solemn audiencën e magjepsur, sytë i vetëtinin me një dritë të çuditshme, pastaj me një zë kumbues tha: – Unë vij nga fronti dhe kam mesazhin e dërguar nga Zoti i Plotfuqishëm!

Fjalët e goditën kishën duke e trandur, por edhe pse i huaji e pikasi këtë efekt, nuk i kushtoi fare vëmendje.

Ai e ka dëgjuar lutjen e shërbëtorit të Tij, bariut tuaj, dhe do t'ia plotësojë

nëse kjo do të jetë dëshira juaj pasi unë, i dërguari i Tij, t'ju shpjegoj domethënien e saj, domethënien e plotë. Sepse si shumë lutje të njerëzve, kërkohet më shumë sesa ai që e thotë është i vetëdijsëm për çfarë kërkon, ngaqë nuk ndalet ta peshojë kuptimin. Shërbëtori i Perëndisë dhe juaji e tha lutjen e tij. Po a është ndalur ta peshojë? A është veç një lutje? Jo, janë dy, një e thënë, tjetra e pathënë. Të dyja kanë arritur në veshët e Atij që dëgjon të gjitha lutjet, të thënat dhe të pathënat. Mendojeni këtë, mos e harroni. Nëse kërkoni një bekim për veten, kini kujdes! Bëjeni pa qëllimin që lutja juaj të jetë mallkim për fqinjin. Nëse luteni për bekimin e shirave për të mbjellat e tua të cilat kanë nevojë, kjo lutje mund të jetë mallkim për të mbjellat e fqinjit të cilit shirat mund t'ia kalbin ato.

Keni dëgjuar lutjen e shërbëtorit tuaj, pjesa e thënë me fjalë prej tij. Jam caktuar nga Zoti që ta shpreh me fjalë pjesën tjetër të lutjes, atë pjesë për të cilën pastori dhe, gjithashtu ju në zemrat tuaja, u lutet me shpirt në heshtje. Dhe pa e ditur dhe pa e menduar? Zoti më tha se kështu ishte! Dëgjuat këto fjalë: “Jepna fitoren, o Zot, Perëndia ynë!” Kaq mjafton. Tërësia e lutjes së shprehur me fjalë mishërohet në këto fjalë kuptimplota. S'kishte nevojë për stërhollime. Kur u lutët për fitore, ju u lutët për shumë pasoja të papërmendura pas fitores, detyrimisht ka pasoja, e pamundur të mos ketë. Në shpirtin dëgjimtar të Atit Perëndi mbërriti edhe pjesa e pashprehur e lutjes. Ai më porositi mua ta shpreh me fjalë. Dëgjoni! O Perëndi, Ati ynë, rinia atdhetare, idhujt e zemrave tona, po nisen për në betejë, qofsh Ti afër tyre! Bashkë me ta, edhe ne po braktisim paqen e ëmbël të ngrohtësisë kaq të

dashur të vatrës familjare për ta dërrmuar armikun. O Perëndi, Ati ynë, na ndihmo t'i bëjmë copë e çikë ushtarët e tyre me predhat tona; na ndihmo t'i mbulojmë fushat gjithë jetë me trupat e pajetë të patriotëve të tyre të vdekur; na ndihmo të mbytet gjëmimi i armëve nga britmat e të plagosurve të tyre në grahamat e dhimbjes; na ndihmo që shtëpitë e tyre bujare t'i fshijmë nga faqja e dheut me stuhi flakësh; na ndihmo që zemrat e vejjshave të tyre fisnike të plasnin prej pikëllimit që s'ka ngushëllim; na ndihmo t'i lëmë pa strehë mbi krye dhe vocërrakët e tyre të enden fillikat në rrënojat e tokës së shkretuar, me zhele në trup, të uritur dhe të etur, të pambrojtur përballë rrezeve përvëluese të diellit të verës dhe ciknave të akullta të dimrit, zemërthyer, të rraskapitur nga stërmundimi, ndërsa të përgjeronen Ty për qetësinë e varrit, por Ti ua mohon. Dëgjoje lutjen tonë për Ty, Perëndi që të adhurojmë dhe lëri të pashpresë, rrënojua jetët. Qoftë i pafund pelegrinazhi i tyre plot vuajtje, hapat i paçin të rëndë! Ujite rrugën ku kalojnë me lotët që derdhin, përskuqe borën e bardhë me gjakun e këmbëve të plagosura! Ta kërkojmë, në frymën e dashurisë, Ty që je burimi i dashurisë, dhe Ty që je streha gjithnjë besnike dhe miku i të gjithë atyre që janë të lënduar dhe kërkojnë ndihmën Tënde me zemra të përlura dhe të penduara. Ashtu qoftë.

(Pas një pushimi të shkurtër.) Këtë lutje bëte. Nëse ende dëshironi që kjo të ndodhë, flisni! Lajmëtar i Më të Lartit po pret! Më vonë besohej se burri kishte qenë i çmendur, sepse s'kishin kuptim ato që ai tha.

/Revista “Akademia”/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Zhdrella: Jam lojtar i lirë, me Llapin u ndamë për shkak të çështjeve financiare

Futbollisti Mentor Zhdrella ka konfirmuar për "Epokën e re" se nga Llapi është larguar pasi nuk gjeti gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit rreth kushteve financiare. "Nuk jam më pjesë e Llapit, pasi nuk kemi arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit rreth çështjeve financiare. Skuadrës së Llapit i dëshiroj suksese në edicionin e ri", ka thënë Zhdrella

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 GUSHT - Katër herë futbollisti më i mirë në Kosovë, Mentor Zhdrella, është lojtar i lirë. Zhdrella gjatë kësaj vere është ndarë me skuadrën e Llapit dy herë dhe ribashkimi nuk pritet të ndodhë më. Për largimin e parë kishte njoftuar skuadra e Llapit zyrtarisht nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare në "Facebook": "Pas një periudhe katërvjeçare të bashkëpunimit, klubi dhe

kapiteni Mentor Zhdrella kanë ndarë rrugët. Si çdo fillim tjetër që e ka fundin, edhe në futboll një fillim çdoherë do ta ketë mbarimin. Megjithatë, jo pa trofe, por me trofeun e Kupës së Kosovës, sepse ishte vetë kapiteni që kishte premtuar se nuk do të largohet nga Llapi pa i sjell trofe".

Pak ditë më pas Zhdrella u rikthye sërish në skuadër, por nuk arriti të merret vesh për kushtet financiare dhe u largua përfundimisht. "Nuk jam më pjesë e Llapit, pasi nuk kemi

arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit rreth çështjeve financiare. Skuadrës së Llapit i dëshiroj suksese në edicionin e ri", ka thënë Zhdrella.

Duke folur për të ardhmen, mesfushori që ka lënë gjurmë në futbollin e Kosovës nuk ka dhënë shumë informata se ku pritret të luajë. "Ofertat nuk kanë munguar asnjëherë, por të shohim se me cilën skuadër do të arrijmë marrëveshje. Tash për tash konkrete nuk ka asgjë", ka shtuar ai.



Mesfushori Mentor Zhdrella për katër vjet rresht ishte zgjedhur lojtari më i mirë në vend, kurse karrierë ka bërë edhe te Prishtina, Hysi, 2 Korriku, Drita dhe Feronikeli.

FIBA Evropa përgëzon FBK-në për organizimin e FIBA U16 European Challenger

PRISHTINË, 24 GUSHT - FIBA Evropa nëpërmjet një letre drejtuar krerëve të lartë të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), kryetarit Arben Fetahu dhe sekretarës së përgjithshme, Elvira Dushku, e ka përgëzuar FBK-në për organizimin e FIBA U16 European Challenger në Prishtinë. FIBA U16 European Challenger, Grupi F, është organizuar në Prishtinë prej 16 deri më 21 gusht në organizim të Federatës së Basketbollit të

Kosovës dhe FIBA Evropës. Kosova, Shqipëria, Luksemburgu, Moldavia, Malta dhe Gjibraltari kanë marrë pjesë në FIBA U16 European Challenger në Prishtinë, ndërsa kanë qenë basketbollistët e Kosova U16 ata që në pesë ndeshje kanë shënuar po aq fitore, dhe kështu janë shpallur kampionë të kësaj gare, në ndeshjen vendimtare kundër Luksemburgut. "Në emër të FIBA Evropës do të doja ta shpreh

mirënjohjen time për federatën tuaj nacionale për organizimin e një (1) FIBA Youth European Challenger 2021 në vendin tuaj. Mbështetja dhe përpjekjet tuaja në lidhje me organizimin, veçanërisht zbatimin e plotë të protokolleve Covid-19, ishin elementet kryesore për zhvillimin e garave që për shumë federata nacionale mund të kenë qenë garat e para zyrtare për gjeneratat e reja pas përhapjes së pandemisë në vitin 2020. Edhe

pse pandemia Covid-19 ende është e pranishme dhe ne mund ta shohim ndikimin e saj negativ në shumë aspekte të jetës sonë të rregullt, fakti që ekipet tona mund të luanin në turne pa ndonjë problem të madh dëshmoi, se ne ngadalë, por sigurt, po i kthehemi fushës së lojës.

Ne ju urojmë suksese për organizimin e edicionit tuaj të kampionateve nacionale 2021/22 dhe me padurim presim



të shohim klubet tuaja dhe ekipet nacionale seniore në garat e ardhshme të FIBA-s", thuhet në letrën e plotë të FIBA Evropës të dërguar nga drejtori ekzekutiv, Kamil Novak.

Përzgjedhësi Nees publikon listën për ndeshjen kundër Anglisë



PRISHTINË, 24 GUSHT - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U21, Michael Nees, e ka publikuar listën e futbollistëve për ndeshjen kualifikuese të Kampionatit Evropianin 2023 kundër Anglisë, e cila zhvillohet më 7

shtator në orën 19:00 në Milton Keynes. Grumbullimi i "dardanëve" të rinj fillon më 30 gusht në Prishtinë, derisa nisja për Angli bëhet më 6 shtator. Në këtë grumbullim përzgjedhësi Nees ka ftuar pesë lojtarë nga kampionati

vendor, kurse një futbollist është ftuar nga Superiorja e Shqipërisë.

Lista e futbollistëve: Leo Besson, Andi Hoti, Valon Zumeri, Bujar Pllana, Florent Hoti, Ismet Lushaku, Valmir Veliu, Edi Sylisufaj, Flamur Gashi, Leard

Sadriu, Florian Haxha, Erion Sadiku, Adrian Pajaziti, Altin Zeqiri, Veton Tusha, Mark Marleku, Egzon Bislimi, Edvin Kurtulus, Albion Pllana, Kreshnik Krasniqi, Altin Kryeziu, Diamant Berisha, Ardit Tahiri.

Khaka konfirmon vazhdimin e kontratës me Arsenalin

Londër, 24 gusht - Granit Khaka vazhdon të jetë pjesë e Arsenalit. Khaka gjatë pothuajse tërë afatit kalimtar është lidhur me një largim nga Arsenali. Futbollisti lidhej me një kalim te Roma ku pëlqej shumë nga

Jose Mourinho, megjithatë e ardhmja e tij mbetet në Angli. Mesfushori ka nënshkruar kontratën e re që do ta mbajë atë tek Arsenali edhe për disa vjet të tjera. Khaka përmes një postimi në llogarinë e

vet në "Instagram" ka bërë me dije se ka rinovuar marrëveshjen me 'Topçinjtë'. Në ndërkohë 'The Gunners' ende nuk ka njoftuar vazhdimin me Khakën, por një gjë të tillë pritret ta bëjë së shpejti.



Ronaldo mund të transferohet te City

Manchester, 24 gusht - Edhe një javë mbyllet afati kalimtar. Juventus ende nuk e di nëse do të jetë në gjendje të llogarisë te Cristiano Ronaldo apo jo për këtë sezon. Ajo që pritej ka ndodhur: rezultati i efektit të mundshëm domino, me Kylian Mbappe si protagonist, ka

zgjatur deri në javën e fundit të tregut të transferimeve. Portugezi është ende një opion për Paris Saint-Germainin në rast se Kylian largohet në drejtim të Realit të Madridit. Përveç kësaj, 'biankonerët', prej muajsh, kanë zgjedhur Gabriel Jesus të Manchester Cityt si zëvendësues i

mundshëm i yllit portugez. Por, "Qytetarët" kanë një prioritet: Harry Kane. Negociatat me Tottenhamin janë shumë të komplikuar, dhe Ronaldo përfaqëson një alternativë për Pep Guardiolan. Në fakt, tashmë ka pasur kontakte, por nuk ka asgjë konkrete.



Shaqiri: Jam shumë i lumtur që iu bashkova Lyonit

LYON, 24 GUSHT - Xherdan Shaqiri ka thënë se ndihet shumë krenar dhe shumë i lumtur që iu bashkua Lyonit dhe se mezi pret ta nisë aventurën e re në Ligën 1. Shaqiri iu bashkua të hënën Lyonit nga Liverpooli për një shumë rreth 11 milionë euro, duke i përfshirë edhe bonuset. Në bisedën e tij të parë si lojtar i Lyonit, përfaqësuesi i Zvicrës, i lindur në Kosovë, tha se kalimi në "Groupama Stadium" e bën të ndihet krenar. "Ndihem shumë krenar dhe shumë i lumtur sepse, më në fund, e nënshkrova kontratën. Tani jam zyrtarisht lojtar i Lyonit", ka thënë Shaqiri për uebsajtën e klubit. 29-vjeçari nënshkroi kontratë trevjeçare me klubin e Ligës 1, ku besohet se do t'i përfitojë nga 4 milionë euro në vit. "Mezi pres t'ia filloj me këtë ekip dhe ta zbuloj klubin. Stadiumi është i mrekullueshëm. E parafytyroj të mbushur plot. Do të jetë e jashtëzakonshme", ka shtuar ai. Shaqiri i zhvilloi 63 ndeshje për Liverpoolin, të cilit i ishte



bashkuar më 2018 nga Stoke City për 15 milionë euro. Por lëndimet luajtën rol të madh për të mos e lejuar atë ta ketë një vazhdimësi të dëshiruar në "Anfield". 29-vjeçari e shijoi një Kampionat Evropian mahnitës Euro 2020 këtë verë, duke i ndihmuar Zvicrës ta arrijë një çerekfinale

historike me tri gola të shënuara. Pas "Euro 2020", Shaqiri i kishte kërkuar Liverpoolit ta lejonte të largohej. Kjo do të jetë liga e katërt e madhe evropiane që Shaqiri do të luajë, pasi në të kaluarën luajti për Bayern Munchenin në Bundesligë dhe Interin në Serinë A.

Verstappen: Koha t'i tregojmë Mercedesit se jemi superiorë

MILTON KEYNES, 24 GUSHT - Max Verstappen ka lënë pas krahëve zhgënjimin e dy garave të fundit të botërorit të Formula 1, nga të cilat mori vetëm 2 pikë dhe humbi kreun e renditjes. Pas pushimeve verore, botërori rikthehet këtë të diel në pistën belge të SPA, me shpresën që Red Bulli të rikthehet protagonist. "Patëm dy gara jo të dobëta, por ishim të pafat me aksidentet që pësua. Gjithsesi, asgjë nuk është e humbur dhe sezoni është i gjatë. Duhet të përqendrohemi te vetja jonë dhe të rikthehemi te fitorja për ta rimarrë kreun", ka thënë Verstappen. "Gjysma e parë e sezonit ishte shumë pozitive, por e rëndësishme është që të jemi agresivë, të shpejtë e fitues përgjatë gjithë sezonit. Nuk më interesojnë rekordet. Unë synoj të fitoj titullin kampion këtë vit", ka



shtuar piloti i ri holandez. Duke folur për garën e radhës në SPA, piloti i Red Bullit ka shtuar: "Kjo është pista ime e preferuar

dhe të pilotoj aty më pëlqen, gjithnjë argëtohem. Natyrisht që kemi shumë shpresa e shanse që të korrin një rezultat të mirë".

SHKURT

Krasniqi e vazhdon karrierën në Indi

Liridon Krasniqi huazohet te skuadra Odisha FC në Superligën e Indisë. Sulmuesi Liridon Krasniqi ka arritur marrëveshje me ekipin e Odisha FC në formë huazimi. Krasniqi e filloi karrierën si futbollist në Republikën Çeke, për të bërë më pas karrierë në Turqi në klubin Ankaraspor. Në vitin 2015 ishte transferuar në Malajzi, ndërsa në dy vjetët në vijim kishte fituar dy tituj. Krasniqi ishte pjesë e ekipit të kombëtares shqiptare U-21, derisa ka qenë pjesë edhe Kosovës. Ai luan tani për Kombëtaren e Malajzisë.

LeBron: Ja ku dëshiroj ta mbyll karrierën time

Pas 17 sezonesh radhazi në NBA, basketbollisti LeBron James kupton se po vjen fundi i karrierës së tij. Pasi ka debutuar me Clevelandin dhe më pas ka veshur edhe fanellën e Miamit, lojtari aktualisht luan me Lakersat. 36-vjeçari, 4 tituj kampionë në NBA, shpreson se objektivi i tij është ta mbyllë karrierën te Lakersat. "Shpresoj realisht që ta mbyll karrierën këtu. Uroj që të luaj edhe 4, 5, 6 apo 7 vjet të tjera me këtë fanellë. Më pëlqen të jetoj në Los Anxhelos", ka thënë LeBron James. "Nuk kisha menduar kurrë se mund të ndihesha kaq komod në këtë skuadër dhe këtë qytet. Uroj që pushimet e këtij viti të më karikojnë dhe të jem në 100 % të formës për ta rikthyer titullin te Lakersat", ka shtuar LeBron, në sezonin e tij të tretë me ekipin kalifornian.

Valverde vazhdon kontratën me Realin deri më 2025

Fede Valverde do të mbetet në Madrid. Sipas gazetarit Mario Cartagena, Valverde do të nënshkruajë kontratën e tij të re me Real Madridin së shpejti. Futbollisti ka kontratë aktuale deri në vitin 2025, por klubi ka dëshiruar ta vazhdojë atë dhe ta blindojë yllin e tyre me marrëveshje të re. Mesfushori do të nënshkruajë edhe për dy vjet, që i bie se do të mbetet në "Santiago Bernabeu" deri në vitin 2027. Paraqitjet e mira të 23-vjeçarit kanë shtyrë drejtuesit e "Los Blancos" që ta vazhdojnë bashkëpunimin. Uruguaiani me kontratën e re do të përfitojë rritje page dhe do të ketë klauzolë largimi prej 1 miliard eurosh.

Ansu Fati rikthehet pas 10 muajsh në stërvitje me Barcelonën

Ansu Fati është rikthyer pas 10 muajsh në stërvitje me Barcelonën. Një vit më parë talenti katalanas pësoi dëmtim të rëndë dhe u operua duke humbur gjithë sezonin. Ai është vetëm 18 vjeç dhe shihet si e ardhmja e Barcelonës. Katalanasit shpresojnë që Fati të jetë në formë pasi sulmi do të vuajë shumë mungesën e Messit. Ndërkohë Fati ka thuar një vjet që nuk luan asnjë ndeshje dhe nuk stërvitet, prandaj do t'i duhet kohë për ta kapur ritmin.

Interi arrin marrëveshje me Torinon për Belottin

Një lajm i bujshëm ka qarkulluar në mëngjes në mediat italiane. Sipas "Tuttomercatoweb", Interi ka arritur pajtim me klubin e Torinos për shërbimet e sulmuesit të kombëtares italiane, Andrea

Belotti. Raportohet se palët kanë gjetur gjuhën e përbashkët për transferimin e "gjelit" te zikaltrit për 15 milionë euro, plus bonuse, teksa pritet vetëm vendimi i sulmuesit. Klubet kërkojnë të mbyllin

marrëveshjen sa më shpejt të jetë e mundur, teksa gjasat janë të mëdha që së bashku me Belottin, në Milano të mbërrijë edhe Correa, për ta blinduar repartin ofensivë të skuadrës së Inzaghit. Interi së

fundmi ka rritur ofertën në 30 milionë euro për sulmuesin e Lazios. Për sa i përket Belottit, sulmuesi 27-vjeçar do të largohet nga Torino pasi ka refuzuar rinovimin e kontratës që i skadon vitin tjetër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION



Nr: 939/1
Dt. 24.08.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr.04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) 07/2017, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur si dhe në bazë të kërkesës se shkollës shpall:

RI-SHPALLJE KONKURSI

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj – paralelet e ndara në Prishtinë

Në kontekstin e reformave të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka zhvilluar nivelin e 5 (pestë) të kualifikimit "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Qendrën e Kompetencës (QeK) në Ferizaj është e akredituar nga Institucioni prestigjioz britanik PEARSON për të ofruar kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore".

Për këtë gjeneratë kualifikim "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore" do të ofrohet në paralelet e ndara në Qendrën e Kompetencës (QeK) "Shjefën Gjeçov" – Prishtinë dhe Qendrën Burimore "Përparimi" – Prishtinë.

Qendra e Kompetencës (QeK) në Ferizaj menaxhohet nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur.

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës Ferizaj	Prishtinë	4 (katër) Mësimdhënës/e me gjysmë norme (10 orë) për kualifikimin "Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore"	Vend i lirë për një (1) vit shkollor)

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënësit e nivelit të V-të arsimin

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës;
- Implementon programin e këtij kualifikimi duke respektuar plotësisht standardet BTEC;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me stanadardin e profesionit dhe programin mësimor;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Nuk mund të kërkoj apo të pranohet udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe AAAPARr-së;
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve;
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të kandidatëve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Merr pjesë në trajnime shtesë të kërkuara nga Qendra e Kompetencës dhe AAAPARr, përfshirë projektet e financuara nga donatorët;
- Ta përditësojë dhe ta përmirësojë në vazhdimësi pakon e materialeve ekzistuese mësimore, dhe të zhvillojë materiale të reja sipas nevojës;
- Mbështet dhe udhëzon kandidatët për realizimin e praktikës profesionale, monitoron dhe mbikëqyrë realizimin e praktikës profesionale;
- Kontribuon në aktivitetet e përgjithshme të monitorimit dhe vlerësimit në Qendrën e Kompetencës;
- Bënë hulumtime specifike për fushën/kualifikimin më qëllim të ngritjes së cilësisë dhe transferimit të njohurive dhe shkathtësive adekuata te kandidatët;
- Kontribuon në zhvillimin e praktikës profesionale duke kontaktuar organizata që mund të konsiderohen si partner potencial, në të cilat mund të organizohet praktika profesionale për kandidatët, nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e stafit drejtues të Qendrës së Kompetencës;
- Të bashkëpunojë rregullisht me organin drejtues të Qendrës së Kompetencës dhe akterët përkatës, në mënyrë që t'i realizojë marrëveshjet formale të bashkëpunimit me partnerët e organizatës duke përdorur veglat adekuata juridike për t'i arritur qëllimet e synuara;
- Të përcjellë në vazhdimësi zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të parapara që duhet të fitohen nga kandidatët gjatë praktikës profesionale. Duke pasur parasysh këtë, duhet të krijohet një raport individual për secilin kandidat ku arsyetohen njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë praktikës profesionale, si dhe ndërlidhjen e tyre me materialet mësimore.

Kualifikimi, shkathtësitë dhe dokumentacioni i kërkuara:

- Diploma e nivelit të 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), drejtimet: Master për Arsim gjithëpërfshirës, Master për Edukim të fëmijëve me nevoja të veçanta ose kualifikim i përafërt;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Të këtë shkathtësi teorike dhe praktike për profesionin e caktuar;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë certifikuar nga PEARSON ose kandidatët e diplomuar në këtë kualifikim;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërta.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e AAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen;
- Shkathtësi themelore kompjuterike dhe kapacitete për t'ia përshtatur në mënyrë sa më të lehtë përdorimin e veglave të TI dhe sistemet e informimit.

Procedurat e konkurrimit

Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacioni dhe dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen (në zyrat e Agjencisë për Arsim dhe Aftësimin Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërtesa MASHTI-II pranë Fakultetit Ekonomik dhe Juridik- kati i III-të, Rr. Agim Ramadani p.n, Prishtinë. Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mergim Asani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. së dhjetë, njëmbëdhjetë, dymbëdhjetë si dhe diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

